



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 4, Datë 17.01.2019**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË  
“KESH” SH.A., PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “ç” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “d”, nenit 5, pika 1, gërma “d” dhe neneve 10, pika 3 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 17.01.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “KESH” sh.a, për licencim në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “KESH” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me Nr. 769 Prot, datë 07.12.2018, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike.
- Në aplikimin e KESH sh.a është konstatuar mungesë dokumentacioni, dhe ERE me shkresën nr. 769/1 Prot., datë 17.12.2018, drejtuar KESH sh.a, ka kërkuar plotësimin e dokumentacionit.
- Në vijim të sa më sipër, KESH sh.a, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 769/2, datë 27.12.2018, ka paraqitur në ERE dokumentacion plotësues për aplikimin e tij.
- Aplikimi i shoqërisë “KESH” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
  - Formati dhe dokumentacioni për aplikim. neni 9, pika 1. Plotësuar.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor. neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”. Plotësuar;
- Dokumentacioni finciar dhe fiskal Neni 9, pika 3. Plotësuar.
- Dokumentacioni Teknik për veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike. Neni 9 , pika 4.7, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”. Plotësuar.
- Neni 9, pika 4.7.1, gërmat “a”, “b”, “c”. Plotësuar.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 2, germa “d”, (vertetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë), gërmën “e”, (struktura e ndërtimit të shoqërisë, Lista e personelit sipas profilit (në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca); Nenin 9, pika 4.7, germa “e” (Sistemi IT); germa “f” (Lista e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës), do t’i kërkohet shoqërisë KESH sh.a, plotësimi brenda afateve të përcaktuara në *“Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “KESH” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**